



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:197803
Datë: 02.05.2024
Numri i dokumentit: 05650097

Ac.nr.2496/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit S.K. avokat nga Komuna e Lipjanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.K., avokat në Lipjan, kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.M., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.821/13 datë 18.12.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paditësit S.K. nga Lipjani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.821/13 i datës 18.12.2019, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.821/13 të datës 18.12.2019, në pikën I, të dispozitivit, ka vendosur: Refuzohet e pabazuar kërkesëpadia e paditësit S.K., avokat nga Komuna e Lipjanit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, ta kompensoj paditësin, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, për shkak të cenimit të rëndë të dinjitetit personal, profesional, integritetit dhe nderit, në shumën e përgjithshme prej 150,000.00 euro (njëqind e pesëdhjetë mijë), me kamatë në lartësinë prej 4,5% vjetore, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në

pagesën definitive, dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumën prej 797.50 euro (shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë cent), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur: Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj si të bazuar ankesën e paditësit, të prishet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ashtu që lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim, ose aktgjykimi të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e autorizuarit të paditësit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, me datë 28.03.2013, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial për shkak të cenimit të rëndë të dinjitetit profesional, integritetit dhe dinjitetit personal, me arsye dhe kërkesë si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.821/13, të datës 18.12.2019, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka parashtruar se nuk është kontestuese fakti se paditësi në cilësinë e avokatit, e ka përfaqësuar në një rast kontestimor Sh.B., deri në përfundimin e procedurës së përmbarimit. Kjo procedurë gjyqësore është zhvilluar në Gjykatën Komunale të Lipjanit, siç edhe konstatohet me aktgjykimin C.nr.642/2005 të datës 16.06.2006, aktgjykimin C.nr.94/2007 i datës 29.05.2007, aktgjykimin C.nr.208/2008 i datës 23.10.2008, aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.133/2009 i datës 05.10.2009, Propozimi për përmbarim i datës 01.12.2009 dhe transferi i mjeteve sipas aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë E.nr.1059/2009, ku transferi i është bërë Sh.B. me datë 26.10.2010, Nuk ishte kontestues që sipas kërkesës së Sh.B., Kryetari Gjykatës komunale në Lipjan kishte hartuar fletëparaqitje penale ndaj paditësit duke e denoncuar për veprën penale të mashtrimit dhe veprën penale keqpërdorimi i besimit. Po ashtu nuk ishte kontestues që Prokuroria publike kishte hedhur poshtë kallëzimin penal pasi është konstatuar se paditësi në cilësinë e avokatit, në raport me klientin e tij i ka përfunduar të gjitha detyrimet, gjegjësisht ka gjetur se asnjë pretendim i paraqitur në kallëzimin penal, nuk qëndron. Ndërsa në anën tjetër Kryetari i Gjykatës si hartues i fletdenoncimit penal, nga e paditura ishte gjetur përgjegjës për shkelje disiplinore të detyrave të punës, për çka edhe i është shqiptuar masë disiplinore. Në këtë rast për palët ndërgjyqëse dhe gjykatën, kontestuese është baza e kërkesës së paditësit, për kompensimin e dëmit material dhe jo material, në emër të cenimit të rëndë të dinjitetit personal, profesional, integritetit dhe nderit të paditësit i shkaktuar nga punonjësi i të paditurës, i cili ishte Kryetar i Gjykatës Komunale në Lipjan, Gjykata pas vlerësimit të gjitha provave dhe me referim në nenin 5 të Ligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia është e pabazuar pasi këtu, punonjësi i të paditurës - kryetari i Gjykatës vetëm e ka përpiluar një

procesverbal sipas kërkesës së qytetarit, përkatësisht ish klientit të paditësit, mirëpo nuk ka përhapur shpifje apo fyerje dhe me përpilimin e procesverbalit nuk është ndikuar në asnjë mënyrë në shkeljen e dinjitetit dhe nderit të paditësit.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar neneve 3 paragraf 1, pika a) dhe 5 paragraf 1 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, lidhur me nenin 7 paragraf 1, 319 paragraf 1 dhe 322 paragraf 1 të LPK-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit, kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditësit se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2, pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për pathemelësinë kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, ashtu që përfundimisht në raport me faktet e rastit, ka zbatuar drejtë ligjin material duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur së gjykata e shkallës së parë, ka vendosur në mënyrë të drejtë duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe rrjedhimisht, duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Sipas Gjykatës së Apelit, me vlerësimin e shkresave të lëndës, rezulton se në këtë rast ish Kryetari i Gjykatës, si punonjësi i të paditurës, nuk ka ndërmarr ndonjë veprim të përhapjes së informatave fyese apo shpifëse ndaj paditësit. Për më shumë, kallëzimi penal është hedhur poshtë nga ana e Prokurorisë, pasi nga faktet e rastit ka rezultuar se paditësi në cilësinë e avokatit në asnjë mënyrë nuk ka kryer veprën penale për të cilën është denoncuar dhe as nuk ka kryer ndonjë shkelje tjetër të etikës profesionale, ashtu siç është konstatuar edhe nga Oda e Avokatëve të Kosovës, ndërsa ndaj Kryetarit të gjykatës, siç rezulton nga shkresat e lëndës, e paditura pas zhvillimit të procedurës disiplinore, ka konstatuar shkelje të detyrave të punës, për çka paditësit ia ka shqiptuar edhe masën disiplinore, e cila masë është vlerësuar si proporcionale me shkeljen e konstatuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me nenin 3 paragraf 1, pika a) të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: “Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër”.

Me nenin 5 paragrafi 1 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: “Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë së ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë ligj”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, pasi që me asnjë provë të administruar dhe të vlerësuar, nuk është vërtetuar se punonjësi i të paditurës ka bërë ndonjë deklaratë e cila do të trajtohej si shpifje dhe fyerje dhe se paditësit i është shkaktuar ndonjë formë e dëmit material apo jomaterial, si pasojë e veprimeve të paditurës.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e paraqitura më lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragraf 1 pika d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2496/20, me datë 19.04.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli